

VENDIM
Nr. 1016, datë 16.12.2020

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SERBISË, PËR LËVIZJEN E NDËRSJELLË
TË SHTETASVE, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 10474, DATË 27.10.2011**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Serbisë, për lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve, ratifikuar me ligjin nr. 10474, datë 27.10.2011, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

MARRËVESHJE NDRYSHUESE
E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SERBISË, MBI LËVIZJEN E
NDËRSJELLË TË SHTETASVE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Serbisë, më poshtë të referuara si “Palët Kontraktuese”,

në bazë të nenit 11 të “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Serbisë, për lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve”, të nënshkruar në Tiranë, më 5 korrik 2011;

me dëshirën për të lehtësuar lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve,
kanë rënë dakord mbi ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Shtojca I dhe II e Marrëveshjes ndryshohet, në mënyrë që shtojca e re të lexojë si vijon: “Lista e dokumenteve të vlefshme të udhëtimit të aplikueshme për shtetasit e Republikës së Shqipërisë, për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje, do të konsiderohen:

- Pasaportë;
- Pasaportë diplomatike;
- Pasaportë shërbimi;
- Një dokument udhëtimi për hyrje (kthim) në Republikën e Shqipërisë;
- Kartë identiteti biometrike.”.

“Lista e dokumenteve të vlefshëm të udhëtimit të aplikueshme për shtetasit e Republikës së Serbisë, për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje, do të konsiderohen:

- Pasaportë;
- Pasaportë diplomatike;
- Pasaportë shërbimi;

- Leje kalimi;
- Kartë identiteti biometrike.”.

Neni 2

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas marrjes së njoftimit të fundit, kur palët kontraktuese, nëpërmjet kanaleve diplomatike, njoftojnë njëra-tjetrën, në lidhje me përmbushjen e procedurave të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Nënshkruar në Tiranë, më 9 nëntor 2020, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast mospërputhjeje në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË SERBISË